

Organet vendore që realizojnë konsultimin publik të parashikuara nga ligji janë:

- Këshilli i Bashkisë**
- Si organ vendimmarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës
- Si organ i detyruar për organizimin e konsultimit publik për një sërë vendimmarrjesh që përcaktohet nga Ligji dhe Regullorja e Këshillit.
- Kryetari i Bashkisë**
- Si organi ekzekutiv i vetëqeverisjes vendore
- Si organi i detyruar nga ligji për konsultim në lidhje me përgatitjen e projekt-buxhetit

afatmesëm dhe planeve të detajuara vendore, por që edhe në përgatitjen e projekt-akteve të tjera mund të organizojë konsultim publik në cdo rast që e gjykon të arsyeshme.

Persona përgjegjës për organizimin dhe realizimin e konsultimit publik janë:

Nga Këshilli i Bashkisë:

- Sekretari / Sekretariati i Këshillit të Bashkisë
- Kryetari i Këshillit
- Kryetarët e Komisioneve të Përherëshme të Këshillit të Bashkisë
- Anëtarët e Këshillit të Bashkisë

Nga Ekzekutivi:

- Kryetari i Bashkisë
- Drejtuesit e Departamenteve/Drejtorive/Sektorëve
- Procesi lehtësohet nga Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik si dhe nga stafi i bashkisë